



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

Nr. 4.84/g Prot.

Pogradec, më 26 . 11 .2025

VENDIM

NR. 118 , DATË 25 . 11 .2025

**“PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QERASË PËR Z.EDMOND ALLA NË
BASHKINË POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24 pika 1, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 3, pika 3, nenit 15, pika 5, nenit 33, pika 1, neni 34 pika 3 germa ç, të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe bazuar në procesverbalin e komisionit të strehimit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. T’i japë Z.Edmond Alla Bonus Qeraje sipas programit të Strehimit Social.

Emër	Mbiemër	Gjendja Sociale	Njësia Administrative	Vlera e Kontratës së Qerasë	Afati i Kontratës	Totali
Edmond	Alla	Kryefamiljar me ndihme ekonomike	Pogradec	12,000Lekë	12 Muaj	144,000 Lekë

2. Efektet financiare të pikës 1,të këtij vendimi në shumën 144,000 (Njëqind e dyzet e katërmijë)lekë, do të mbulohen nga Fondi Rezervë i Bashkisë Pogradec.



3. Pagesa e qirasë do të kryhet në bazë të paraqitjes së kontratave të qirasë dhe kushteve të strehimit që parashikohen në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, pranë Drejtorisë së Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec.

4. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 21 vota

2. Vota Pro 21

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 25.11.2025

